

BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET - VITI I TRETË- SEMESTRI V

Analiza e pasqyrave financiare [O]: 7 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të i kuptojnë konceptet e përgjithshme të analizave financiare, të jenë në gjendje që të përpilojnë dhe analizojnë këto pasqyra financiare apo edhe duke krahasuar me pasqyra tjera financiare. Të kuptojnë mënyrat e matjes së krahasuar të riskut dhe kthimit në marrjen e vendimeve të investimit apo kreditimit. Do të vlerësojnë gjendjen financiare të suksesit dhe perspektivës së kompanive.

Tregjet Financiare [O]: 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të njohohen me tregjet financiare, nocionet e tregjeve financiare në ekonomi, të aftësohen në vlerësimin e ndikimit të tregjeve financiare në lëvizjet financiare në kontekst të situatave të caktuara, të vlerësojnë ndikimin e tregjeve financiare në sistemin financiar në ven, në ekonomin e vendit dhe më gjerë.

Financat Publike [O]: 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohurit e duhura për financat publike si disiplinë e ekonomisë, se cilat funksionet bazike të saj, se çka janë shpenzimet publike, të hyrat publike dhe tatimet, të njohohen me politikat fiskale, doganat, taksat, kontributet, huat publike dhe buxhetin në përgjithësi. Të kuptojnë shpenzimet qeveritare, analizojnë politikat qeveritare etj.

Financat Ndërkombtare [O]: 6 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të njohohen me marrëveshjet, procedurat, rregullat dhe institucionet ndërkombëtare financiare, të aftësohen në bilancet e pagesave dhe politikat makroekonomike në ekonominë e tregut në botën

bashkëkohore, tregtinë bankiere, koleksionimin dhe kreditimin ndërkombëtar, financimi i tregtisë ndërkombëtare, financimi i biznesve ndërkombëtare.

Menaxhimi Bankar [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të aftësohen në menaxhimin e bankave, të analizojnë problemet praktike të menaxhimit të bankave, të menaxhojnë kapitalin bankar, menaxhojnë likuiditetin. Do të njoftohen me menaxhimin e solvenitetit dhe rreziqet e menaxhimit bankar, menaxhimin e të ardhurave bankare, veprimtarin kreditore të bankave dhe sistemin informativ të menaxhimit të bankave.

Menaxhimi Strategjik [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të njoftohen me njohurit e duhura se çka është strategjia, të kuptojnë se pse janë shumë të rëndësishëm vendimet strategjike. Të aftësohen në proceset e menaxhimit strategjik, të i kuptojnë studimin dhe parashikimin e mjedisit, analizat konkurruese, analizat e mjedisit të brendshëm, zgjedhjen dhe vlerësimin e alternativave strategjike, zbatimin e strategjive, kontrollin dhe menaxhimin e ndryshimeve.

Kompetencat ndërkulturore [Z]: 5 ECTS

Qëllimi i këtij kursi është rritja e aftësisë së studentit për të punuar në një ambient me kultura të ndryshme. Kursi ka për qëllim edhe masterizimin e kulturave përfshirë racën, nacionalitetin edhe gjinitë. Në disa tema diskutohet edhe rëndësia e medias sa i përket aspekteve kulturore. Do të shohin interaksionin në rritje të kulturave të ndryshme dhe bashkëpunimi mes tyre në aspekte kulturore, të njoftohen edhe me termat e globalizmit, migrimit, diversitetit të kulturave etj.

BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET - VITI I TRETË- SEMESTRI VI

Shkrim Akademik dhe Metodologjia Hulumtuese [O]: 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të aftësohen në metodat e studimit, punimet profesionale, rregullat metodologjike për hartimin e punimeve profesionale, të njoftohen me llojet e punimeve profesionale, hapat të cilët duhet ti ndërmarrin në punimet e tyre profesional, fusnotat, resurset bibliografike. Gjithashtu studentët do të shofin metodologjitë bashkëkohore hulumtuese të cilat edhe praktikisht do të transmetohen në punimet e tyre të ardhme profesionale.

Menaxhimi Financiar [O]: 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të pajisen me njohuri të duhura të menaxhimit financiar, njohuri mbi vendimet e financimit, investimit dhe dividendit, interpretimi i pasqyrave dhe raporteve financiare, vlerën në kohë të parasë, burimet e financimit, riskut, strukturën e kapitalit dhe menaxhimit të kapitalit të punës.

Auditim [O]: 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të aftësohen në revizionim të raporteve financiare, ti dijnë parimet e përgjithshme dhe standarde të revizionimit. Ti mësojnë konceptet themelore dhe teknikat e revizionimit, kompletimi i saj, të aftësohen në revizionimin e raporteve financiare dhe llogarive të lidhura, në elementet themelore të raport-revizionimit etj.

Ekonometri [O]: 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të pajisen me njohuri të koncepteve statistikore të krahasuara me të lëndës së statistikës, analizave ekonometrike, faktorët e regresionit(OSL), analizat e të dhënave të problemeve ekonomike, probabilitetin dhe interreferencën statistikore, regresioni linear. Njoftimi me disa pajisje softuerike statistikore dhe ekonometrik për analiza të të dhënave.

Etika në Banka dhe Kontabilitet [Z]: 4 ECTS

Qëllimet e kësaj lënde janë që studentët të fitojnë njohurit e konsiderueshme në etikën e të bërit kontabilitet dhe në banka. Të aftësohen në konceptet themelore të etikës, kodin standard të etikës në banka dhe kontabilitet, zhvillimi e koncepteve të etikës në banka dhe kontabilitet, të aftësohen në hartimin dhe zbatimin e disa rregullave të kodit të etikës në banka dhe kontabilitet, zgjidhjen e problemeve, konflikteve të interesim, ndershmërinë, paanësinë dhe komunikimin.

E drejta Bankare dhe Financiare [Z]: 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të aftësohen në të drejtat juridiko-ekonomike të bankave dhe institucioneve financiare, në sjellët dhe zbatimin e normave juridike për bankat dhe financat, rolin e organeve shtetërore mbi bankat dhe financat, njohjen e sistemit juridik shtetërore mbi bankat dhe financat, aktet juridike bankare dhe financiare të ndërmarrjeve.

E drejta Bankare dhe Financiare e BE-se [Z]: 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të pajisen me njohuri bazike juridike-ekonomike të sistemit bankar dhe financiar të Bashkimit Europian. Të aftësohen me normat juridike bankare dhe financiare të tregut të BE-së, të shohin rolin e organeve shtetërore të BE-së në sistemin bankar dhe financiar, të njihen me sjellët e normave juridike të shteteve evropiane në tregjet bankare dhe financiare.

Teknologjia e Informacionit ne afarizmin bankar [Z]: 4 ECTS

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të marrin njohurit e duhura të ndikimit të Teknologjisë Informative në afarizmin bankar, në projektimin dhe planifikimin e projekteve në proceset afariste bankare, të integrohen me aftësitë e tyre në shumë koncepte, mjete dhe teknika që përfshihen në menaxhimin e projekteve afariste bankare.

Punimi i diplomës dhe praktika [O]: 4 ECTS